

Data 17/07/2023

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME  
(PROCEDURË E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR)  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË MONITORIMIT TË TRANSFORMATORËVE TË FUQISË DGA, BMT TË HEC FIERZË, KOMAN DHE VAU DEJËS”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** SHËRBIME MIRËMBAJTJEJE 98341110-9.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 180,700,000 (Njëqind e tetëdhjetë milion e shtatëqind mijë) Lekë pa TVSH ose 1,765,338 (Një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e tetë) Euro pa TVSH.

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 17/07/2023 është 102.36 Lekë/Euro.***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

**Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetë deklaratimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të

vogël”, Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklaratimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetë deklaratimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit.

*Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

Duke marrë në konsideratë specifikën e objektit procedure prokurimi, kërkohet që Operatorët Ekonomik ofertues të paraqesin vërtetime të cilat vërtetojnë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar këtë procedurë prokurimi në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2020, 2021, 2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

***Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.***

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

**a)** Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ✚ ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- ✚ ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

**Argumentimi:**

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Janë kërkuar këto certifikata, që të vërtetojnë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standardeve ndërkombëtare të cilat reflektojnë dukshëm edhe në cilësinë e shërbimit. Çertifikatat e kërkuara për OE janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

**ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** - Ky standart është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

*Sa më sipër janë kërkuar certifikata që të vërtetojnë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standarteve ndërkombëtare të cilat reflektojnë dukshëm edhe në cilësinë e shërbimit. Kërkesat janë të mjaftueshme për të siguruar ofertues me kapacitete teknike cilësore të çertifikuara edhe me certifikata menaxhimi të cilësisë të njohura ndërkombëtarë. Çertifikatat e kërkuara për OE janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Çertifikatat e kërkuara janë vendosur në përputhje me specifikimet teknike si dhe u arsyetuan të nevojshme për të siguruar ofertues serioze.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën që vërteton që sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit/ve të jetë sipas standartit ISO 9001:2015 e përshtatshme për objektin e prokurimit.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

#### **2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- ✚ Letër bashkëpunimi ndërmjet tij dhe prodhuesit ose autoritete/institucione/ente të autorizuar të seteve DGA dhe BMT për mirëmbajtjen e tyre.
- ✚ Letër bashkëpunimi me prodhuesin ose autoritete/institucione/ente të autorizuar për marrjen përsipër për trajnimin e personelit në lidhje me sistemet e DGA & BMT si dhe pajisjes portative DGA, për operimin dhe mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve.

Argumentimi: Objekti kryesor i prokurimit është mirëmbajtja e sistemeve të monitorimit të transformatorëve të fuqisë, të cilat janë sisteme ekzistuese të të njëjtit prodhues. Për shërbime specifike të sistemit që kanë të bëjnë me konfigurime, parametrizime dhe interpretime të thelluara të matjeve është i domosdoshëm suporti i prodhuesit ose autoritete/institucione/ente të autorizuar të cilët kanë ekspertizën e duhur për të realizuar me sukses këtë kontratë. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka suportin e prodhuesit ose autoritete/institucione/ente të autorizuar për gjithë periudhën e mirëmbajtjes, që të garantojë autoritetin kontraktor që do të realizohet cdo shërbim mirëmbajtje këtyre sistemeve.

Pajisjet portabël të matjes së gazrave të çliruar në vajin e transformatorit, janë pajisje shumë specifike të cilat kanë metodika të ndërlikuara të matjes dhe interpretimit e vlerave të matjeve.

Për këtë arsye operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka mbështetjen nga prodhuesi ose autoritete/institucione/ente të autorizuar për të realizuar trajnimin e specialistëve të KESH sh.a, për sistemet e monitorimit të vajit të transformatorëve dhe izolatorëve kalimtar.

#### **2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të punësuar për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023).

- ✚ Minimalisht (një) inxhinier elektrik;
- ✚ Minimalisht 1 (një) specialist/inxhinier të certifikuar nga prodhuesi ose ent certifikues i akredituar për pajisjet monitoruese DGA & BMT, i cili do të realizojë këtë shërbim.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë**

**pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:**

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomën e inxhinierit;
- ✚ Çertifikatën e mësipërme të vlefshme, të çertifikuar nga prodhuesi ose ent çertifikues i akredituar.
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023).

**Argumentimi:**

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Paisjet kryesore të sistemeve të monitorimit të gazrave janë të instaluara në trupin e transformatoreve të fuqisë. Gjatë shërbimeve të mirëmbajtjes që do të realizohen sipas specifikimeve, operatori ekonomik, duhet të garantojë që punimet do të realizohen duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik dhe personeli do të udhëhiqet të paktën nga një punonjës që dëshmon se është i aftë të menaxhojë punime në paisje të tensionit të lartë.

1 (një) specialist/inxhinierë i cili të jetë i çertifikuar nga prodhuesi ose ent çertifikues i akredituar, për pajisjet monitoruese DGA & BMT, është një kërkesë në përputhje me objektin e kontratës pasi proceset e zbatimit të saj, referuar kërkesave teknike të përcaktuara në Specifikimet teknike janë specifike, për këtë arsye kontraktori duhet të ketë aftësinë e duhur për realizimin me sukses të kontratës. Duke qënë se shërbimet do të kryhen direkt nga prodhuesi, operatori ekonomik duhet të realizojë shërbime mirëmbajtje profilaktike cdo 3 (tre) muaj, dhe duhet të hartojë një raport mbi gjendjen e sistemit cdo muaj. Për të dëshmuar që operatori ekonomik ka kapacitete teknike për të realizuar këto shërbime duhet që të ketë të paktën një specialist/inxhinierë të çertifikuar për sistemet e monitorimit të transformatorëve të fuqisë DGA dhe BMT.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose distributor i autorizuar për paisjet DGA portative.

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.*

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet

njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.3.7** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun e prodhuesit/ve, ku të jenë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat teknike në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike.

*Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT. Katalogu duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe për mallrat objekt prokurimi.*

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

**Shënim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Specifikime teknike për mirëmbajtjen e sistemeve të mirembajtjes së transformatoreve DGA dhe BMT janë hartuar referuar standarteve IEEE dhe praktikave të mirëmbajtjes të ketyre sistemeve.

Mirëmbajtja është e planifikuar për 4 vite, ku do të përfshihen remontet profilaktike interpretim i të dhënave dhe ndërrim pjesësh nëse do të jetë e nevojshme. Mirëmbajtja është konceptuar e tillë që shërbimet të jenë periodike në kohë dhe përfshin cdo lloj shërbimi të mundshëm që sistemet të jenë funksional.

Brenda objektit të mirëmbajtjes është përfshirë furnizim i një pajisje portative e cila është konsideruar si një masë shtesë, për kontrollin e matjeve të relizuara dhe për të bërë matje të gazrave dhe të vajit në transformatorët e tjerë të nevojave vetjake, vajit rezervë etj.

Gjithashtu në objektin e kontratës është përfshirë edhe përmirësimi i software të menaxhimit, për të përfituar risitë e fundit në lidhje me monitorimin.

Në lidhje me aksesin e sistemit nga distanca do të përmirësohet mënyra e komunikimit ku do të instalohet një licensë në nivel server në KESH sh.a, ku do të jetë shumë më e sigurtë marrja e të dhënave nga specialist përkatës të KESH sh.a.

## **Njësia e Prokurimit**